

USAID në mbështetje të bujqësisë shqiptare



TIRANË, 18 Shkurt /ATSH/-Ambasadori amerikan në Tiranë, Donald Lu dhe Ministri i Bujqësisë, Edmond Panariti morën pjesë në aktivitetin e zhvilluar sot në ambientet e Hotel Tirana Internacional, me rastin e 1-vjetorit të programit të USAID-it, "Agrokapital", që mbështet bujqësinë shqiptare.

Ky projekt po zbatohet nga Creative Biznes Solutions(CBS), një organizatë konsulence biznesi, jo fitim-prurëse, e cila ofron këshillim dhe krijon zgjidhje për sipërmarrjet lokale, organizatat, donatorët dhe Institucionet Financiare

Ministri Panariti gjatë fjalës së tij falënderoi bankat dhe institucionet e mikrokredisë në Shqipëri, të cilat u solidarizuan me fermerët e prekur nga përmbytjet në jug të vendit, duke shtyrë shlyerjen e kësteve të kredive.

Kreu i Bujqësisë bëri të ditur se qeveria ka vendosur të mbartë kreditë që kanë me agjencitë e mikrokreditit, rreth 1000 familje fermere, të prekura nga përmbytjet, që shkon në një vlerë prej 1.5 milion euro.

"Ne kaluam një periudhë shumë të vështirë, që ka qenë periudha e përmbytjeve, të cilat padyshim patën efektin e tyre negativ në bujqësi. Vlen të përmendet fryma e solidaritetit nga partnerët ndërkombëtarë, por dhe nga biznesi e individë të veçantë që bënë të mundur të futemi në programin e rigjallërimit të shpejtë të bujqësisë", deklaroi ministri Panariti.

Ministri i Bujqësisë theksoi se qeveria është e orientuar nga investimet gjithëpërfshirëse në bujqësi, duke përmendur disa nga prioritetet e këtij viti.



"Prioritet për këtë vit janë investimet në pikat e mëdha të grumbullimit, magazinimit që ne i konsiderojmë si enët e munguara. Janë ato që lidhin prodhimin me tregun. Duhet të rrisim ndjeshëm edhe ofertën. Rritja e ofertës do të bëhet natyrisht, duke investuar në sektorin e serave", deklaroi Panariti.

Ndërsa Ambasadori amerikan, Donald Lu, shprehu keqardhje për familjet e shumta shqiptare që kanë humbur fermat dhe bagëtitë e tyre, nga vërshimi i lumenjve në jug të vendit.

"Shpresoj që ndihma amerikane, e ofruar përmes USAID-

it, do t'i ndihmojë këto familje. Këto përmytje nuk e kanë dëmtuar vullnetin e popullit shqiptar. Jemi të kënaqur të mbështesim Agrokapitalin, nëpërmjet USAID-it. Por ka ende shumë biznese që kanë ende nevojë për qasje në kapital, në mënyrë që të rriten”, deklaroi ambasadori Lu.